

# NE PUNOJMË



# PËR KOSOVËN

## NE MENDOJMË PËR POPULLIN

VALBON (14), DRILON (15), HALIL (14), ALMA (15), ADHURIM (14), DREN (14), SHQIPONJE (14)



**Grupi ynë i takon klasës së IX-të dhe sot kemi biseduar për të drejtat dhe përgjegjësitë e popullit por edhe për qytetarinë aktive. Ne në vazhdim do t'ju tregojmë pikërisht për këto tema**

Qytetar konsiderohet çdo person që ka të drejtën e jetesës në Kosovë. Ndërkaq, qytetari aktive do të thotë kur të gjithë qytetarët që jetojnë në Kosovë japin kontributin e tyre. Për të qenë një qytetar aktiv, duhet

nuk duhet të ngasim veturën nëse nuk e kemi moshën e duhur për ngasje. Ne duhet të respektojmë njerëzit me nevoja të veçanta, të moshuarit dhe shkollën. Ne duhet të votojmë kryetarin e duhur, e jo atë që nuk kujdeset për shtetin e vet. Ndërsa, si fëmijë ne kemi përgjegjësi të përfundojmë shkollën, të ndihmojmë fëmijët të cilët nuk kanë veshmbathje dhe ushqim. Pra, ne duhet të jemi aktiv në lagjen, shkollën, qytetin dhe shtetin tonë.



Si duhet vepruar dhe si nuk duhet vepruar me mbeturinat



Shkolla jonë nënkupton të drejtën e shkollimit

respektuar së pari rregullat dhe ligjet. Qytetar aktiv është ai i cili merr pjesë në organizata të ndryshme, në aktivitete të ndryshme, ai i cili mbron ambientin, si dhe kryen obligimin e tij qytetar siç është e drejta e votës. Por, një qytetar aktiv në Kosovë ka të drejta dhe përgjegjësi të cilat duhet t'i respektoj.

Ne kemi të drejtë të votojmë, të shkollohemi, të luajmë. Të drejtat të cilat na i mundëson shteti ynë, ne nuk duhet t'i keqpërdorim. Të drejtat dhe përgjegjësitë dallohen nga njëra-tjera në forma të ndryshme. Ne



Autorët e artikullit

# TË BASHKUAR GJITHMONË PËR DEMOKRACI

ARLIND (14), BESARTA (15), ALBIN (15), DETARE (14), ARGJEND (14) ELMA (13), TRINGA (14),

RINORI (14)



## Rëndësia e demokracisë është që qytetarët të jetojnë të lumtur në paqe

Ne si fëmijë apo si nxënës të klasës së IX-të jemi qytetarë të Republikës së Kosovës, pra qytetarë të një vendi demokratik. Demokracia fillet i kishte në Greqi, më saktësisht në Athinë. Ajo u formua në vitin 507 para erës së re, dhe rrjedh nga fjalët greke: „demos që do të thotë popull dhe „kratia“ që do të thotë qeverisje. Në krahasim me ditët e sotme, demokracia në fillim të formimit të saj nuk po zhvillohej edhe shumë, për shkak se elementet përbërëse të saj, pra barazia, të drejtat, liria e shprehjes, respekti, toleranca, solidariteti nuk përfillleshin në mënyrën e duhur. Njerëzit që kishin pasuri më të mëdha kishin më shumë të drejta pothuajse në çdo aspekt, por gratë ishin më të kufizuara në të drejtat e tyre.

Sot, çdo gjë është ndryshe. Të drejtat e njerëzve janë të barabarta dhe çdo njeri është i lirë të shprehë mendimet e tij dhe të bëjë atë që dëshiron pa i penguar të tjerët. Pra, demokracia është formë e qeverisjes ku populli vendos për atë që mendon se është më e arsyeshme për vendin e tij.

Ka dy forma të demokracisë: demokracia përfaqësuese dhe ajo e drejtpërdrejtë. Demokracia përfaqësuese është ajo kur populli zgjedh një individ apo një grup njerëzish. Kjo do të thotë se populli zgjedh atë që mendon se është përfaqësues më i denjë i vendit

të tyre. Demokracia e drejtpërdrejtë, ndryshe nga ajo përfaqësuese, kryhet përmes formave të ndryshme si peticione ose referendume, ku populli me formimin e peticioneve dhe referendumeve kërkon atë që i duket më e drejtë në formimin dhe zhvillimin e vendit të tyre. Dallojmë po ashtu dy sisteme të demokracisë përfaqësuese: sistemi parlamentar dhe ai presidencial. Në vendin tonë, pra në Kosovë kemi sistemin parlamentar. Parlamenti ose Kuvendi ynë përbëhet nga 120 deputetë, ku 100 prej tyre përfaqësojnë popullin shumicë, kurse 20 të tjerë përfaqësojnë ata jo shumicë siç janë romët, ashkalinjtë, egjiptianët, boshnjakët, serbët, turqit si dhe goranët. Pra, nga gjithë kjo çfarë shënuam, na bën të kuptojmë që në ditët e sotme nuk ka vend për jo tolerancë, pa barazi e jo solidaritet e kufizim të lirisë së njerëzve. Të gjithë duhet të jemi të barabartë!



Autorët e artikullit



## RËNDËSIA E VOTËS

ARBËR (15), ALBIN (15), FITORE (14), ELZA (14), ANESA (14), AJLINDA (14), DIANA (14), ERVIN (14)



### Ne si gazetarë të Kosovës dëshirojmë t'iu informojmë më shumë për zgjedhjet

Gjatë diskutimit me grupin tonë kemi arritur të mësojmë shumë gjëra të lidhura me demokracinë dhe zgjedhjet demokratike. Ne mësuam se fjala „demos“ ka prejardhjen nga greqishtja dhe do të thotë popull, ndërsa „kratia“ do të thotë udhëheqje. Demokracia paraqitet në dy forma, në demokracinë direkte dhe demokracinë përfaqësuese.

Kosova, vendi ynë ka demokraci përfaqësuese. Kjo do të thotë se ne qytetarët e Kosovës votojmë për deputetët çdo 4 vjet. Për këtë arsye, themi se deputetët janë përfaqësuesit e qytetarëve të Kosovës. Këta deputetë punojnë në Kuvendin e Kosovës dhe gjithsej janë 120 deputetë.


Ne mendojmë se deputetët duhet gjatë gjithë kohës t'i përfshijnë kërkesat tona dhe jo interesat e veta personale. Deputetët duhet të jenë të sjellshëm dhe të

ndershëm me popullin.

Zgjedhjet, sipas bisedës sonë, janë një proces ku qytetarët votojnë kandidatët më të mirë. Në Kosovë kemi 2 lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet lokale dhe parlamentare. Në zgjedhje lokale ne votojmë për kryetarin e komunës dhe asamblenë e komunës, kurse në zgjedhjet parlamentare ne votojmë dhe zgjedhim deputetët e Kuvendit të Kosovës.

Ne nuk votojmë vetëm për këto lloj zgjedhjesh, por ne bëjmë edhe zgjedhje të përditshme. Zgjedhjet e përditshme mund të jenë të ndryshme. P.sh. kur zgjohemi në mëngjes ne zgjedhim rrobat që veshim, këpucët që do t'i mbathim. Zgjedhjet mund t'i bëjmë edhe në shkollë, dyqane, bibliotekë, etj. Kur të rritemi ne mund të bëjmë zgjedhjen e profesionit, dhe po ashtu mund të votojmë mbi moshën 18 vjeçare.

Ne besojmë dhe mendojmë se vota jonë do të sjellë një të ardhme më të mirë në vendin tonë.



Në demokraci të gjithë jemi të barabartë



Grupi i gazetarëve të demokracisë

# PËRFAQËSUESI I POPULLIT

ALTIN (14), ELMA (14), EGZON (15), FJOLLA (14), LORIK (14), MEDINA (14), YLL (14), YLLKA (14)



## Cilat janë funksionet e Kuvendit?

Kuvendi është një ndër institucionet më të fuqishme dhe më të rëndësishme në vendin tonë. Dikush nga lexuesit mund të pyet pse është institucioni më demokratik? Kuvendi është institucioni më demokratik, sepse deputetët të cilët ndryshe quhen përfaqësues të popullit janë të zgjedhur direkt nga populli. Si i tillë që është, ka disa funksione siç janë: miraton ligjet ose ndryshe njihet si Pushteti Legjislativ, përfaqëson popullin i cili ia ka besuar votën, si dhe mbikëqyr Qeverinë. Ai është i përfaqësuar nga 120 deputetë, ku 20 prej tyre janë të komuniteteve jo shumicë, ndërsa 100 i përkasin kombit shqiptar.

Të gjithë këta deputetë, në fillim të mandatit e bëjnë betimin e deputetit në mënyrë që detyrat dhe përgjegjësitë e tyre t'i përfundojnë në mënyrë më demokra-

tike të mundshme.

Kush ka të drejtë të kandidoj për deputet? Të drejtën për të kandiduar për deputet e gëzon çdo qytetar mbi moshën 18 vjeçare, që d.m.th., edhe në kur të arrijmë këtë moshë mund të kandidojmë për deputeët. Për t'u zgjedhur deputet, duhet të plotësohen disa kritere siç janë: arsimimi, etika e punës, mbajtja e premtimeve etj.

Kuvendi përbëhet nga pozita (partia që ka fituar më së shumti vota) dhe opozita. Përveç deputetëve në seanca marrin pjesë edhe Kryeministri dhe ministrat të cilët përfaqësojnë Qeverinë, dhe në këtë mënyrë, Kuvendi e mbikëqyr Qeverinë duke iu parashtruar pyetje për çështje të ndryshme.

Populli zgjedh deputetët, ndërsa deputetët përfaqësojnë popullin.



Fjalimi i një deputeti



Grupi i parë





## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Ganimete Tërbeshi“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX-1  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Llukar, Prishtinë